



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2633 prot.

Gramsh, më 17/01/2023

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8/2, neni 9/1.1 pika "b"; neni 59/2, neni 64/g; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar; Bashkia Gramsh, njofton shpalljen për:

**1 (një) vend të lirë pune në pozicionin: Kryeinspektor i IMT-së, në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit;**

**2 (dy) vende të lira pune në pozicionet: Inspektor i IMT-së, në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit;**

**Lloji i diplomës:** "Drejtimi, Inxhinieri e ndërtimit, Arkitekturës, Urbanistikës, Konstruksionit, Transportit, Tekno-logjisë së materialeve, Gjeologjisë, Hidrogjeologjisë dhe Mjedisit"

**Niveli minimal i diplomës:** Për pozicionin Kryeinspektor "Master Shkencor"

Për pozicionin inspektor "Bachelor"

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si mësipër është:**

**Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore:**

Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

- a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;
- ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;
- dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;
- ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;

## **KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT:**

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

## **KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E VECANTA SI VIJON:**

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" ose "Master Shkencor apo Profesional", në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit, në administratën shtetërore dhe/ose institucioneve të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Jetëshkrim i plotësuar ;
3. Fotokopje të diplomës dhe lista e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Certifikatë familjare;
7. Certifikatë personale;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
10. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
11. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajtimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 31.07.2023**

